



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UJËSJELLËS KANALIZIME KAMËZ SH.A

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Kamëz, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/ 2023

**Lënda: Blerje inerte për ndërhyrjet në rrugë.**

## RELACION DHE SPECIFIKIME T E K N I K E

Shoqëria **Ujësjellës-Kanalizime Kamez sh.a** me fondet e vëna në dispozicion për nevojat tona do të realizoj blerje materiale ndërtimi :

### **1. Qëllimi**

Kjo blerje konsiston në hartimin e nje liste materialesh qe i duhen grupeve të punës në përditshmerine e vet për riparim difektesh ujesjellës dhe në kanalizime ,në rrugë hapje kanalesh etj.

### **2. Vendndodhja**

Këto materiale që blihen do të perdoren në të gjithë territorin e Bashkise Kamëz për nevojat e U.K.Kamez sh.a.

### **3. Gjendja e infrastruktures ekzistuese**

Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Kamez sh.a. ka nevojë që në përditshmërin e punëve të saj të riparoj shumë difekte si dëmtim të rrugës gjatë hapjes së kanaleve qoftë për lidhje uji ose kanalizime të qytetarëve , dëmtime në rrugë rurale dhe si pasojë duhen mbushur me çakull dhe stabilizant, për të bërë lidhjen e abonentëve me rrjetin kryesor të U.K.K. sh.a .

## **SPECIFIKIME TEKNIKE**

### **I - TE PERGJITHSHME**

#### **1.1 HYRJE**

Qëllimi i përgatitjes së këtij kapitulli është sqarimi i kërkesave për Kontraktorin në lidhje me Projektin, ecurinë e punës konform kushteve teknike të zbatimit, Kontratës, Legjislacionit ne fuqi për mbrojtjen e punonjesve, të ambientit dhe publikut si dhe detyrimeve që duhet të plotesojë Kontraktori gjatë zbatimit te kontratës.

#### **1.2 DOKUMENTAT**

Të gjitha dokumentat e tjera teknike që shoqërojnë këtë projekt do të jenë bazë për vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së materialeve që do të blihen.

Kontraktori duhet të shqyrtojë projektin që në fillim të punës dhe përpara lidhjes së Kontratës me Investitorin e Objektivit.

Kontraktori do të verifikojë të gjitha sasinë dhe kërkesat e vëna nga Investitori.

Kontraktori do të marrë përsiper të gjithë përgjegjësinë në kryerjen e llogaritjeve për sasinë dhe llojet e materialeve, volumeve të punës si dhe materialeve të kërkuara për blerje .Cdo ndryshim nga Preventivi i blejeve të materialeve të ndërtimit do të bëhet vetëm në bashkëpunim me projektuesit dhe me aprovim të Investitorit.

#### **1.3 ZEVENDESIMET**

Zëvendësimet e materialeve të specifikuar në projekt do të bëhen vetëm me aprovimin e Investitorit. Këto zëvendësime do të bëhen vetëm nëse materiali i propozuar është me cilësi të njëjta ose më të mira se materiali që do të zëvendësohet. Kërkesa për zëvendësimin e materialeve duhet të shoqërohet me dokumenta që tregojnë cilësinë e materialit të propozuar dhe të dhënat teknike dhe të dhëna nga prodhuesi i këtij materiali. Duhet të kihet paraysh se nuk do të njihet asnjë pagesë shtesë apo ndryshim mbi cmimin njësi të dhënë nga Kontraktori në Ofertën e tij dhe të pasqyruar në Preventivin e objektivit që shoqëron Kontratën.

## 1.4 ZERAT E PUNES DHE MATERIALET

### 1. ÇAKULL MAKINERIE

Çakulli i makinerisë është material me përbërje granulometrike 20~50mm me përbërje të grimcave argjilore jo më tepër se 10%, dhe pas hapjes në objekt bëhet ngjeshja me makineri.

- Përbërja granulometrike për furnizim do të jetë sipas fraksioneve :

Fraksioni 20-30mm , Fraksioni 30-40mm , Fraksioni 40-50mm

### 2. GRANIL I IMET GURI

Granil i imët guri është çakull i imët i dimensioneve 10-20mm i dale nga frontoja që përdoret në shtresa rrugore sipër shtresës së çakullit.

- Furnizimi i sasive dhe përbërjeve granulometrike të çakullit të makinerise do të bëhet sipas përcaktimeve të UKK.sh.a., në varësi të gjendjes së rrugëve rurale dhe nevojave të Njësive Administrative në vendet e përcaktuara prej sajë.

### 3. STABILIZANT

Stabilizanti është një shtresë që hidhet mbi cakëllin e thyer dhe ku boshllëqet mbushen me fraksione më të imta duke krijuar një shtresë kompakte. Stabilizant është një shtresë me material si makadami por përzierje e parapërgatitur para shtrimin në objekt. Punimet e dherave nuk do të përmbajë material copëzues (prishës) si p.sh. pjesë shkëmbinjsh të dekompozuar ose material argjilor. Agregati i thyer duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

(a) Vlerën e copëzimit të aggregateve

(b) Indeksi i plasticitetit (PI) nuk duhet të tejkalojë 6.

d) Kërkesat për ndarjen (shkallëzimin)

Shkallëzimi do të bëhet sipas kufijve të dhëna në tabelën e mëposhteme: Tabela  
Shkallëzimi për shtresë themeli të përbërë prej gurësht të thërrmuar. Përmasat e sitës  
(mm) Përqindja që kalon (sipas masës).

Permasa (ne mm)	50	28	20	10	5	1.18	0.3	0.075
Perqindja ekalimit ne site	100	84-94	72-94	51-67	36-53	18-33	11.21	8-12.00

Provat për të përcaktuar nëse materiali prej gurësh të thërrmuar i plotëson kërkesat e specifikuar të shkallëzimit do të bëhen para dhe pas përzierjes dhe shpërndarjes së materialit.

#### 4. ÇIMENTO 42.5R

Çimentoja portland përbëhet nga klinker dhe gips. Është i përshtatshëm për përdorim të përgjithshëm. Është i përshtatshëm për t'u përdorur në rastet kur kërkohet kallëp i hershëm (aplikime të parafabrikuara). Preferohet për derdhje betoni në mot të ftohtë Ofron forcë të lartë të hershme dhe përfundimtare. Ofron rezistencë të lartë të hershme dhe përfundimtare në prodhimet e betonit të gatshëm. Ai lejon prodhimin me nxehtësinë e tij të lartë të hidratimit në mot të ftohtë. Përftohet si rezultat i bluarjes së aditivëve mineral (shtuf dhe gëlqeror) dhe klinkerit të çimentos portland së bashku me një sasi të caktuar rregullatorit të ngurtësimit (gips) në një normë të përcaktuar në standarde (maksimumi 20%); Është një produkt që fiton forcë duke ngrirë pas një kohe pasi është përzier me ujë. Në përgjithësi, mund të përdoret në të gjitha aplikimet ku përdoret çimentoja portland. Përveç kësaj, nxehtësia e hidratimit të saj është më e ulët se çimentoja portland. Për shkak të nxehtësisë së ulët të hidratimit, sulfatëve dhe/ose klorurit etj. Është i përshtatshëm për t'u përdorur në punimet e betonit të kryera në mjedise agresive.

#### 5. RERE E LARE NE LAVATRICE

Të gjitha këto janë materiale që merren nga lavatriçja dhe frontoja janë me parametra dhe cilesinë e punimeve sipas KTZ e sipas standarteve shtetërore.

Këto materiale merren nga pikat e Liçensuara nga shteti për shitje.

## **1.5 GRAFIKU DHE METODOLOGJIA E PUNIMEVE**

Kontraktori pas shqyrtimit të Projektit dhe gjendjes aktuale ne vend duhet të pregatitë Grafikon e Punimeve dhe Metodologjine e Puneve sipas të cilave do të sjellë materialin për të plotësuar kërkesat e zbatimit të kontratës në kohën, sasinë dhe cilesinë e duhur. Grafiku i sjelljes së materialeve do të paraqesë aktivitetet kryesore që do të bëjë Kontraktori për përfundimin me sukses të shërbimit sipas kontratës.

Grafiku i sjelljes së materialeve do të kordinohet në bashkëpunim me U.K.Kamëz sipas nevojave . Materialet do të transportohen nga kontraktori sipas një grafiku të bashkrenduar me degën teknike direkt në rrugë apo kanalizimin që ka nevojë ndërmarrja duke u mbajtur proces-verbalet në kordinim mes Degës teknike – magazinës –financës dhe Kontraktorit që do të sjelli mallin.

### **UJESJELLES KANALIZIMEVE KAMEZ sh.a**

**Ing.Admir Petku**

**Ing.Xhuana Metuka**

### **DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**Eris MARTINI**